




REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Punëpunës/Prodator Received/Delivered	18-08-2022	2	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinstvo Org. Unit	Nr. Prot. Pr. Prot. Prot. No.	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKUPSHICK	4785	2022	1/4



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.619/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin e ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, si dhe Sabile Avdyli-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, sipas Aktgjykimit A.nr.2454/2021 i datës 13.07.2022 i Gjykatës Themelore në Prishtinë -Departamenti për Çështje Administrative, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.619/2021 të datës 08.07.2021 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi kundër organit të punësimit Shërbimi Korrektues i Kosovës, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 18.08.2022 mori këtë:

V E N D I M

- I. **APROVOHET** si e bazuar ankesa me numër A.nr.619/2021 e datës 08.07.2021 të parashtruar nga ankuesi
- II. **Mbetet në fuqi** Vendimi Nr.0385 i datës 09.02.2021 i Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës.
- III. **OBLIGOHET** Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, në pajtim me legjislacionin në fuqi të ndërmarrë veprimet e nevojshme për harmonizimin e koeficientit të ankuesit sipas Vendimit Nr.0385 të datës 09.02.2021.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vend

Arsy et im

Ankuesi i punësuar si Depoist kuzhine në Qendrën Korrektuese në Dubravë sipas akt emërimit të datës 05/03/2013 në Shërbimin Korrektues të Kosovës me datë 08.07.2021 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 3565/2021 të regjistruar me numër A.nr.619/2021, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor kundër Shërbimit Korrektues të Kosovës për njohje të së drejtës së harmonizimit të koeficientit të pagës nga pesë (5) në gjashtë (6).

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 13.07.2021 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Shërbimi Korrektues i Kosovës, ndërsa Këshilli me datë 22.07.2021 ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga data 30.06.2021 ka qenë jo funksional dhe nuk ka vendosur për ankesën e ankuesit, ndërsa më datë 23.08.2021, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka njoftuar ankuesin për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës duke udhëzuar që mund të ndiqni procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ mund të filloni procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesi, pasi ka pranuar Njoftimin e datës 23.08.2021 me numër protokoll 4312/2021, ka parashtruar padi pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, duke iniciuar konflikt administrativ, e cila me datë 13.07.2022 ka nxjerrë Aktgjykimin me numër Anr.2454/2021 me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e ankuesit, duke anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 23.08.2021 për ankesën me numër Anr.619/2021, duke e detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, që brenda 30 ditësh të vendos për ankesën e datës 08.07.2021 me numër protokoll 3565/2021.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, me rastin e shqyrtimit të kësaj ankese dhe me qëllim të vendosjes meritorë ka administruar këto prova: Ankesën e datës 08.07.2021 me numër protokoll 3565 të regjistruar me numër A.nr.619/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Aktgjykimin A.nr.2454/2021 i datës 13.07.2022 i Gjykatës Themelore në Prishtinë -Departamenti për Çështje Administrative; Njoftimi i datës 23.08.2021 me numër protokoll 4312/2021 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Akt emërimi i datës 19.10.2017; Konkursi i Brendshëm i datës 03.07.2019 për pozitën Zyrtar i Depos në Qendrën Korrektuese në Lipjan me koeficient gjashtë (6); Njoftim i datës 05.08.2018: Kërkesa e datës 15.09.2021 për ngritjen e koeficientit; Përgjigje në ankesë nga organi i punësimit i datës 26.07.2021 me numër protokoll 3908/2021; Vendimi Nr.0385 i datës 09.02.2021 i Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës; Përshkrimi i detyrave të punës për Zyrtar i Depos i datës 16.05.2007 dhe lista e pagave për muajin qershor 2021.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka analizuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa me numër A.nr.619/2021 e datës 08.07.2021, e parashtruar nga ankuesi është e bazuar, sepse

Bazuar në shkresat e lëndës Kolegji ka konstatuar se ankuesi është i punësuar në Shërbimin Korrektues të Kosovës që nga data 03.03.2003 ndërsa sipas Akt emërimit të datës 05.03.2013, ankuesi



mban pozitën Depoist kuzhine në Qendrën Korrektuese në Dubravë, me koeficient pesë (5) të pagës.

Ankuesi, me datën 15.09.2020 ka parashtruar kërkesë tek Drejtori i Qendrës Korrektuese në Dubravë lidhur me harmonizimin e koeficientit nga pesë(5) në gjashtë (6). Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës me vendimin e datës 09.02.2021 me numër protokolli 0385 ka aprovuar kërkesën e ankuesit për harmonizimin e pagës, respektivisht për ngritjen e koeficientit nga pesë (5) në gjashtë (6).

Sipas shkresës të datës 22.07.2021 Menaxheri i Personelit i Shërbimit Korrektues të Kosovës ka theksuar se janë përcjellë në Thesarin e Kosovës formularët për ndryshim bashkë me vendimet, mirëpo Drejtori i Përgjithshëm i Thesarit të Kosovës nuk i ka ekzekutuar vendimet me arsyetimin se kjo çështje lidhet me riorganizimin e Administratës Shtetërore.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenin 19 ku përcaktohet se *"Zyrtari publik ka të drejtë në page dhe shpërblim për punën e kryer, si dhe shtesa të përcaktuara me Ligjin e Pagave"* si dhe neni 3 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil me të cilin parashihet se *"1. E drejta e nëpunësve civilë për pagë të drejtë dhe të rregullt është e garantuar në bazë të kushteve të përcaktuara me këtë ligj dhe me Ligjin e Shërbimit Civil. 2. Institucionet e administratës publike të Republikës së Kosovës janë të detyruara të paguajnë pagë të njëjtë për punën me vlerë të njëjtë"*, e si rrjedhojë Kolegji ka konstatuar se nëpunësit civil të cilët kryejnë detyra të njëjta të punës dhe që kanë kualifikimet dhe përvojën e kërkuar për nivelin e pozitës, duhet të paguhet njëjtë respektivisht me page të njëjtë.

Bazuar në shkresat e lëndës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka konstatuar se organi i punësimit respektivisht Shërbimi Korrektues i Kosovës gjatë vitit 2019 me datë 03.07.2019 ka shpallur konkursin e brendshëm për pozitën Zyrtar i Depos në Qendrën korrektuese në Lipjan e me të cilin konkurs për pozitën Zyrtar i Depos është paraparë koeficienti 6 (gjashtë), po ashtu në shkresat e lëndës kemi edhe Akt emërimit të datës 19.10.2017 e Zyrtarit të Depos(Z.S) në Burgun e Sigurisë së Lartë me koeficient 6(gjashtë).

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ju referua edhe dispozitave të Ligjit Nr.05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi sa i përket fushëveprimit të këtij ligji në nenin 2 përcaktohet se: *"1. Ky ligj zbatohet për të gjitha veprimet apo mosveprimet, të të gjitha institucioneve shtetërore dhe lokale, të personave fizik dhe juridik, të sektorit publik dhe privat, të cilët shkelin, kanë shkelur ose mund të shkelin të drejtat e çdo personi apo personave fizik dhe juridik, në të gjitha fushat e jetës, e posaçërisht që kanë të bëjnë me: 1.3. kushtet e punësimit dhe të punës, përfshirë shkarkimin apo ndërprerjen e kontratës dhe pagesës"*; si dhe nenit 3 paragrafi 1 dhe 2 të të njëjtit Ligj ku përcaktohet se *"1. Parimi i trajtimit të barabartë nënkupton se nuk do të ketë kurrfarë diskriminimi të drejtpërdrejtë apo të tërthortë sipas kuptimit të cilido nga bazat e përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji. 2. Diskriminim është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë në çfarëdo baze të përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji, që ka për qëllim apo efekt të zhvlefhtësoj ose çenon njohjen, gëzimin ose ushtrimin, në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave dhe lirive themelore të njohura nga Kushtetuta dhe ligjet tjera të aplikueshme në Republikën e Kosovës."*

Andaj, bazuar në rrethanat si më lartë Kolegji vlerëson se Shërbimi Korrektues i Kosovës, ka obligim ligjor të veproj për zbatim të vendimit të datës 09.02.2021 të Drejtorit të Përgjithshëm për harmonizim të koeficientit të pagës sikurse kolegët e tij me pozitë të njëjtë pune nga se bien në kundërshtim me nenin 4 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi ku

përcaktohet se: "1.1. Diskriminimi i drejtpërdrejtë konsiderohet kur një person trajtohet në mënyrë më pak të favorshme sesa ka qenë i trajtuar ose do të trajtohet një person tjetër në një situatë të krahasueshme, sipas një apo më shumë nga bazat e përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji"

Bazuar në gjendjen faktike si më lartë ,organi i punësimit respektivisht Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës është i detyruar që në pajtim me legjislacionin në fuqi të ndërmerren të gjitha veprimet për plotësim ndryshimin e akt emërimit për ankuesin me qëllim të harmonizimit të koeficientit nga 5(pesë) në 6 (gjashtë)sipas Vendimit 0385 i datës 09.02.2021.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerr veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e Vendimit të Këshillit.

Kolegji, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.


Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda:A.nr.619/2021,datë 18/08/2022

Sabile AVDYLI



Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- ❖ Ankuesit
- ❖ Gjyqtarës Administrative; Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje
- ❖ Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës;
- ❖ Udhëheqësit të Personelit në Shërbimin Korrektues i Kosovës dhe
- ❖ Arkivit të KPMSHCK-së.

